



GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:134647
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05428298

C.nr. 79/2015

GJYKATA THEMELORE G. – DEGA V., gjyqtari, Alush Sinani, me bashkëpunëtorin profesional, Agon Halabaku, në çështjen juridike kontestimore të paditësve, N.S., nga fshati B., komuna e V., të cilin e përfaqëson me autorizim F.S.avokat në G., Z.S., N.S.dhe M.S., të gjithë nga fshati B., komuna e V. kundër të paditues Komuna e V., me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit e 4,500.00 euro, jashtë seance, me datë 06.03.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

I. Ndërprehet procedura, në çështjen juridike kontestimore të paditësve, N.S., nga fshati B., komuna e V., të cilin e përfaqëson me autorizim F.S.avokat në G., Z.S., N.S.dhe M.S., të gjithë nga fshati B., komuna e V. kundër të paditues Komuna e V., me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit e 4,500.00 euro.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë, sipas propozimit të palës, pasi të kenë pushuar shkaqet e ndërprerjes së kësaj procedure.

Arsyetim

Në këtë gjykatë është në procedurë e sipër lënda sipas padisë së paditësve, N.S., nga fshati B., komuna e V., Z.S., N.S.dhe M.S., të gjithë nga fshati B., komuna e V. kundër të paditues Komuna e V., me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit e 4,500.00 euro.

E paditura, në përgjigje në padi ka theksuar se meqense i gjithë dokumentacioni-regjistrat kadastral i cili ka rregulluar komasacionin në teritorin e Komunës së V., që nga përfundimi i luftës së V.t 1999, janë marrë nga organet e atëhershme dhe tani janë në Republikën e Serbisë, pra Komuna e V. nuk disponon dokumentacionin, ka kerkuar që procedura të ndërpritet deri sa të kthehet dokumentacioni kadastral, që pastaj edhe në procedurë administrative paditësit do të mundën që të vërtetojnë pronësinë, përkatsisht pretendimet e tyre.

Meqenëse për gjykatën është fakt i ditur se vërtet regjistrat lidhur me paluajtshmëritë që kanë qenë të përfshira në procedurën e masës së komasacionit në Komunën e V., në përfundim të luftës së V.t 1999, janë marrë nga organet e atëhershme dhe tani janë në Republikën e Serbisë, kështu që në mungesë të dokumentacionit - regjistrave kadastral, nuk ka shënime nëse

Numri i lëndës: 2019:134647
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05428298

aktvendimet për ndarje nga masa komasative janë ekzekutuar dhe/ose kanë qenë të formës së prerë.

Në këto rrethana, gjykata ka vlerësuar se paraprakisht duhet të zgjidhet çështja e kthimit të regjistrave për paluajtshmëritë e përfshira në procedurë, respektivisht në masën e komasacionit, andaj, duke u bazuar në nenin 278.1 të LPK-së, sipas të cilit është paraparë se: “Përveç rasteve të parashikuara me këtë ligj, gjykata e ndërpret gjykimin: a) po që se ka vendosur që vet të mos e zgjidhë çështjen paraprake”, vendosi për ndërprerjen e procedurës.

**GJYKATA THEMELORE G. - DEGA E GJYKATËS V.
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:134647, 06.03.2024
C.nr.79/2015**

G j y q t a r i
Alush Sinani

KËSHILLË JURIDIKE:Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afatin prej 15 ditëve, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa eventuale në kopje të mjaftueshme dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.